

VENDIM
Nr. 885, datë 16.12.2016

PËR SHPËRBLIMIN E PENSIONISTËVE PËR FESTAT E FUNDVITIT, 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin, në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë, të personave, për vitin 2016, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) Personat që marrin pension sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) Personat që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, dhe personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

ç) Personat që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

d) Personat që marrin pension pleqërie sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”;

dh) Personat që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar si veteranë të LANC-it, sipas vendimit nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare të popullit shqiptar”, si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm, për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të llogaritura në shumën 3 754 800 000 (tre miliardë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër milionë e tetëqind mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i sigurimeve shoqërore, i miratuar për vitin 2016.

Shpërblimet të kalohen në llogaritë e pensionistëve në muajin dhjetor 2016 dhe të paguhen gjatë këtij muaji. Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit dhjetor 2016, ato paguhen edhe gjatë vitit të ardhshëm.

3. Procedura e pagesës dhe e administrimit të shpërblimit për pensionistët të realizohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe “Posta Shqiptare” sh.a.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe “Posta Shqiptare” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama